

Programi Buxhetor Afatmesëm 2021-2023

**BASHKIA FUSHË – ARRËZ
QARKU SHKODËR**

Shtator 2020

Propozuar Këshillit të Bashkisë më

Datë 14 /09/ 2020

Bashkia Fushë – Arrëz

”Fushë - Arrëzi si një qytet që po ripërtërihet ekonomikisht duke u mbështetur në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, potencialeve pyjore dhe në turizmin malor”

Mirënjohje

Prezantimi i Programit Buxhetor Afatmesëm tashmë vjen në një tjetër format dhe dimension sa financiar aq edhe strategjik. Konfigurimi i tij përtej kontureve financiare i jep atij rolin e duhur në zbatimin e politikave të zhvillimit ekonomik vendor të parashikuara në Planet Strategjike, si dhe hap perspektiva të reja zhvillimi për të gjithë komunitetin tonë. Ky dokument mëshiron punën e palodhur të një grupi të gjerë specialistësh dhe anëtarësh të komunitetit tonë të cilët prej vitesh janë pjesë e pandarë e ekipit tonë qeverisës.

Falënderimet më të veçanta i drejtohen të gjithë anëtarëve të komunitetit të cilët jo vetëm i dhanë jetë realizimit të këtij procesi por e udhëhoqën atë me përkushtim. Sjellja e të gjithë aktorëve në proces dëshmon më së miri qëndrimin tonë në përfshirjen e komunitetit në bashkëqeverisje. Vëmendja, angazhimi dhe përkushtimi i Kryetarit të Bashkisë, Z. Fran Tuci jo vetëm lehtësoi këtë program por i dha atij një vlerë të patjetërsueshme në forcimin e dialogut me të gjithë bashkëpunëtorët tanë.

Tash e disa vjet ne kemi treguar se dimë të analizojmë të shkuarën dhe të planifikojmë të ardhmen, ne dimë të punojmë të gjithë së bashku dhe të ndajmë me njëri – tjetrin sukseset e përbashkëta, të bashkëpunojmë dhe të ndërtojmë ura të forta bashkëpunimi me qeverisje qendrore dhe donatorët.

“Një qëllim pa një plan është veçse një dëshirë”

(Antoine de Saint-Exupéry)

Të nderuar bashkëpunëtorë!

Jo pa qëllim solla në vëmendjen Tuaj këtë shprehje të shkrimtarit francez Antoine de Saint – Exupéry. Prej vitit 2015 të gjithë së bashku kemi konfiguruar misionin dhe vizionin e qytetit tonë e natyrshëm kemi projektuar një listë të gjatë prioritetesh të cilat shkojnë përtej mundësive tona financiare dhe administrative. Natyrisht nuk është aspak e lehtë t’i japësh jetë të gjithë dëshirave tona, por vitet që lamë janë dëshmitari më i mirë i përpjekjeve dhe angazhimit tonë në realizimin e projekteve konkrete pjesë e Strategjisë sonë të Zhvillimit. Formuluar si një “Plan Veprimi” Programi Buxhetor Afatmesëm ecën në gjurmët e Strategjisë sonë të Zhvillimit dhe njëherësh rivlerëson të gjithë kuadrin e mëparshëm strategjik bazuar në impaktin dhe rezultatin të cilin ne synojmë të arrijmë në periudhën afatmesme.

Kemi ecur në rrugën e duhur sakohë që parashikimet tona përputhen me pritshëmritë tuaja, çka na bën optimist për përmbushjen e të gjithë angazhimeve tona jo vetëm në rrafshin strategjik por edhe financiar. Një buxhet i mirë-organizuar dhe mbështetur në prioritetet strategjike shton akoma më shumë përgjegjësi për të gjithë ne. Realizimi i projekteve të projektuara por edhe atyre të planifikuara në rrugë e sipër tashmë do të përbëjë shtyllën kurrizore të këtij procesi dinamik dhe gjithëpërfshirës

Gjej rastin të falënderoj të gjithë anëtarët e komunitetit tonë, institucionet e përfshira në proces dhe Këshillin e Bashkisë për mbështetjen e pakursyer që i kanë dhënë këtij procesi dhe jam i bindur se ndihma dhe angazhimi i tyre nuk do të mungojë.

Tani e më tej, të gjithë bashkë, ne do të ofrojmë çdo ditë e më shumë kontributin tonë për t’i dhënë jetë realizimit të projekteve të planifikuara dhe objektivave të përcaktuar.

“Fushë – Arrëzi, si një qendër e vogël dhe e ripërtëritë urbane, e përfshirë në realitetin e zhvillimeve të ardhshme rajonale në veri të Shqipërisë, një pikë qendrimi dhe çlodhëse për njerëzit dhe aktivitetet e ndryshme ekonomike, një qytet i ripërtëritë ekonomikisht që mbështetet në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe potencialeve pyjore dhe në turizmin malor”.

Fran TUCI

Kryetar Bashkie

1. Vështrim i përgjithshëm

1.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore



Bashkia Fushe Arrez

Bashkia Fushë Arrëz shtrihet përgjatë ish rrugës kombëtare Shkodër – Kukës – Prishtinë dhe gjendet në pjesën verilindore të Shqipërisë. Në kontekstin gjeografik, Bashkia Fushë – Arrëz shtrihet në një zonë malore me një sipërfaqe prej 540 km², ku 927 ha e zënë toka bujqësore. Qyteti i Fushë Arrëzit njihet si një

qendër e vogël industriale ku ka mbizotëruar për vite me rradhë industria e përpunimit të drurit dhe fabrika e pasurimit të bakrit. Burimi kryesor i punësimit deri tani është fabrika e përpunimit të bakrit së bashku me disa punishte të vogla të për prodhimin e lëndës drusore. Zhvillimi perspektiv i qytetit është i lidhur ngushtësisht me industrinë e përpunimit të drurit dhe të mineraleve si dhe sektorin e turizmit malor dhe kultivimit të bimëve mjekësore.

Fushë – Arrëzi, është një Bashki me burime njerëzore të kualifikuara, si në nivelin e administratës vendore ashtu edhe në strukturat e sipërmarrjes së biznesit, kulturës, sportit dhe arsimit që nxisin krijimin e një klime të favorshme për biznesin vendas e të huaj dhe mundësitë për punësim duke reflektuar rritje të qëndrueshme të të ardhurave për banorët. Bashkia Fushë Arrëz është një vend i sigurt, i pastër dhe tërheqës për banorët dhe komunitetet në rritje, të cilët kanë mundësi të përmirësojnë shëndetin dhe mirëqenien e tyre në bashkëveprim me pushtetin vendor. Bashkëpunimi me donatorë dhe me Qeverinë Shqiptare mundëson jo vetëm përmirësimin e infrastrukturës së qytetit tonë por edhe shërbimet publike të ofruara për komunitetin.

Vizioni

“Fushë – Arrëzi, si një qendër e vogël dhe e ripërtërirë urbane, e përfshirë në realitetin e zhvillimeve të ardhshme rajonale në veri të Shqipërisë, një qytet i ripërtërirë ekonomikisht, që mbështetet në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe potencialeve pyjore dhe në turizmin malor”

Misioni

Fushë – Arrëzi, si një Bashki me burime njerëzore të kualifikuara, si në nivelin e administratës vendore ashtu edhe në strukturat e sipërmarrjes së biznesit, kulturës, sportit dhe arsimit, që nxisin krijimin e një klime të favorshme për biznesin vendas dhe të huaj dhe mundësitë për punësim në rritje të qëndrueshme të të ardhurave për banorët”

Fushë – Arrëzi, një vend i sigurt, i pastër dhe tërheqës për banorët dhe komunitetet në rritje, të cilët kanë mundësi të përmirësojnë shëndetin dhe mirëqenien e tyre në bashkëveprim dhe me sens qytetar dhe kanë kapacitetin dhe shtysën për të dhënë kontribut efektiv në të ardhmen e Bashkisë dhe qytetit”

1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë

Burimi i informacionit: PPV/PZhS

1.3 Informacion financiar Kryesor

Burimi i informacionit: Nxjerrë nga Instrumenti i Planifikimit Financiar

2. Orientimi afatgjatë i bashkisë

Fushë – Arrëzi, është një Bashki me burime njerëzore të kualifikuara, si në nivelin e administratës vendore ashtu edhe në strukturat e sipërmarrjes së biznesit, kulturës, sportit dhe arsimit që nxisin krijimin e një klime të favorshme për biznesin vendas e të huaj dhe mundësitë për punësim duke reflektuar rritje të qëndrueshme të të ardhurave për banorët. Bashkia Fushë Arrëz është një vend i sigurt, i pastër dhe tërheqës për banorët dhe komunitetet në rritje, të cilët kanë mundësi të përmirësojnë shëndetin dhe mirëqenien e tyre në bashkëveprim me pushtetin vendor. Bashkëpunimi me donatorë dhe me Qeverinë Shqiptare mundëson jo vetëm përmirësimin e infrastrukturës së qytetit tonë por edhe shërbimet publike të ofruara për komunitetin.

Objekti ynë Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë sonë vjen tashmë jo vetëm në dimensionin financiar por i integruar brenda Programit Buxhetor Afatmesëm. Evidentimi i prioritetëve gjatë këtij procesi shërbeu si pikënisja e aksionit tonë të përbashkët në gjetjen dhe alokimin e burimeve financiare të nevojshme për realizimin e tyre. Së bashku kemi evidentuar 118 prioritete të cilat, pavarësisht natyrës kapitale apo jo-kapitale synojnë të përmirësojnë cilësinë e jetës së komunitetit tonë në periudhën afatmesme – afatgjatë. Vetëm për këtë periudhë janë evidentuar 52 projekte. Në vitin që lamë pas, përpos përmirësimeve të vazhdueshme në drejtim të rritjes së kapaciteteve financiare ne jemi mundur të alokojmë mjaftueshëm

burime financiare në financimin e prioriteteve të evidentuara. Natyrisht që ka shumë punë për të bërë, por gjithsesi, financimi i të gjithë projekteve të planifikuara dhe projekteve të reja konsiderohet ende një proces në vazhdim. Bashkëpunimi me donatorë dhe me Qeverinë Shqiptare ka mundësuar jo vetëm përmirësimin e infrastrukturës së qytetit tonë por edhe shërbimet publike të ofruara për komunitetin.

Trajtuar në kontekstin strategjik, Programi Buxhetor Afatmesëm i jep rrugë zhvillimit të qytetit tonë jo vetëm nga pikpamja e financimit të projekteve kapitale por edhe nga një mënyrë e re parashikimi, zbatimi, vlerësimi, monitorimi dhe raportimi të aktivitetit të Bashkisë. Në këtë aspekt, ky dokument prezanton jo vetëm arritjet e Bashkisë në vite por edhe programon veprime dhe përgjegjësi konkrete për periudhën në vazhdim. Dinamika e realizimit të projekteve kapitale dhe jo-kapitale tashmë do të ofrojë prognozë të plotë mbi nivelin e realizimit të Qëllimeve dhe Objektivave Strategjik të cilët janë në sinkron të plotë me Vizionin dhe Misionin e Bashkisë. Tashmë ne vijmë jo vetëm para komunitetit tonë por edhe donatorëve me një dokument i cili flet jo vetëm mbi bazë prioritetesh por edhe me terma financiarë. Objektivat tona të Zhvillimit të Bashkisë sonë evidenton katër fusha prioritare të zhvillimit perspektiv të Bashkisë të cilat janë pikënisja e formulimit të Programeve Buxhetore dhe Politikave dhe Objektivave respektiv. Përmirësimi i sistemit buxhetor nëpërmjet tranzicionit nga buxheti mbi bazë artikujsh te buxheti mbi bazë programi synon rishpërndarjen e shpenzimeve buxhetore bazuar në pritshmëritë dhe nivelin e realizimit jo vetëm të projekteve konkrete por mbi të gjitha koston qëllimet dhe objektivat strategjike në vlerë dhe në kohë, duke krijuar të gjitha mundësitë për monitorimin dhe vlerësimin e progresit në përmbushjen e Vizionit të Planit Strategjik të Zhvillimit Ekonomik.

2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë

Burimi i informacionit: PZhS

4. Informacion Financiar

Sa i përket tavaneve është e rëndësishme të shpjegojmë faktin se janë respektuar shifrat e dërguara nga Ministria e Financës për Transferta të pakushtëzuar. Transferata specifike ka ruajtur nivelin e vitit 2019 me ndryshim vetëm në vitin 2022 me një shtesë prej 5% sipas udhëzimit nr. 7, datë 27.2.2019. Transferata e kushtëzuar është përlogaritur nga ana jonë duke marrë si bazë vitin e kaluar si dhe shpenzimet për 5-mujorin e parë të vitit 2019. Të ardhurat e veta janë planifikuar me rritje. Këto trende reflektohen dhe në zërat e shpenzimeve sipas klasifikimit të tyre

1.1 Burimi I të ardhurave.

Tabela F1: Analize për parashikimin e të ardhurave për periudhën 2018 – 2023

Të ardhurat e Bashkisë për periudhën afatmesëm do të vijnë nga Taksat dhe Tarifatat Vendore të cilat janë programuar në përputhje me Paketën Fiskale të hartuar dhe të miratuar në Këshillin e Bashkisë si dhe transferata të pakushtëzuar, transferata e kushtëzuar dhe ajo specifike. Është shumë rëndësishme të përmendim se gjatë gjithë materialit tonë ne do të referohemi të dhënave mbi nivelin e realizimit të të ardhurave për periudhën Janar – Dhjetor 2019 dhe planit vjetor të të ardhurave për vitin 2020. Duke kaluar një për një të

gjitha të ardhurat buxheti i Bashkisë sonë mbështetet në planifikimin e të ardhurave të veta dhe transfertave nga qeveria qendrore.

Zyra e Taksave në Bashki ka planifikuar në mënyrë analitike taksat dhe tarifat vendore si dhe të ardhura të tjera me natyrë jotatimore. Planifikimi të ardhurave jo vetëm i hap rrugë përcaktimit të tavaneve buxhetore por ndërton profilin e programeve dhe politikat e shpenzimeve për sejcilin prej tyre dhe produkteve specifike të planifikuara, Por çfarë ka ndodhur me të ardhurat në vite? Cila është tendenca e tyre? Si kanë progresuar? Sa kanë kontribuar ato në buxhetin e Bashkisë? Për të adresuar përgjigjet për sejcilën prej pyetjeve të mësipërme mjafton të shohim tabelën F1 e cila sjell në vëmendje pikërisht realizimin e të ardhurave të buxhetit tonë në vite sipas klasës të cilës ato i përkasin.


1.2 .Të ardhurat në formë tabelore

Parashikimi i të ardhurave


Bashkia Fushë Arrëz të ardhurat për periudhën afatmesëm do ti sigurojë nga Taksat dhe Tarifat Vendore të cilat janë përlogaritur në përputhje me Paketën Fiskale të hartuar dhe të miratuar në Këshillin e Bashkisë, si dhe nga transferta e pakushtëzuar, transferta e kushtëzuar dhe ajo specifike. Zyra e Taksave në Bashki ka planifikuar në mënyrë analitike taksat dhe tarifat vendore si dhe të ardhurat e tjera me natyrë jotatimore. Planifikimi të ardhurave jo vetëm i hap rrugë përcaktimit të tavaneve buxhetore dhe produkteve specifike të planifikuara, por ndërton profilin e programeve dhe politikat e shpenzimeve të secilit prej tyre.

Burimi buxhetor	Fakt 2018	Fakt 2019	I Pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	20,952	21,753	29,010	28,555	28,555	28,555
Të ardhura nga taksat locale	5,877	4,893	10,172	10,172	10,172	10,172
Të ardhura nga taksat e ndara	1,515	1,739	4,573	4,573	4,573	4,573
Të ardhura nga tarifa vendore	4,363	6,129	7,210	7,210	7,210	7,210
Të ardhurat e tjera	9,197	8,992	7,055	6,600	6,600	6,600
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	427,928	352,658	247,870	247,472	252,995	259,935


Transferta e pakushtëzuar	94,413	76,293	77,686	74,190	79,713	85,709
Transferta e kushtëzuar	259,885	201,378	94,681	97,779	97,779	97,779
Trasferta specifike	73,630	74,987	75,503	75,503	75,503	76,447
HUAMARRJA	0	0	0	0	0	0
Huamarrja afatshkurtë	0	0	0	0	0	0
Huamarrja afatgjatë	0	0	0	0	0	0
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	138,610	102,119	457	0	0	0
Trashëgimi pa destinacion	116,442	80,244	0	0	0	0
Trashëgimi me destinacion	22,168	21,875	457	0	0	0
TOTALI	587,490	476,530	277,337	276,027	281,550	288,490




Të ardhurat sipas burimeve buxhetore 2017 – 2022



■ TË ARDHURA NGA BURIMET E



TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA



TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA

Shpenzimet

Tabela F6,F7 shpenzimet sipas funksionit dhe koment;

Bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7 datë 27.02.2019 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023”, Udhëzimin nr. 23, datë 22/11/2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” Bashkia Fushë - Arrëz ka planifikuar shpenzimet sipas programeve buxhetore për periudhën afatmesme pjesë e Programit Buxhetor 2021-2023. Planifikimi i shpenzimeve në Bashki ka ndjekur strukturën e Programeve Buxhetore të miratuara dhe është në përputhje të plotë me tavanet e shpenzimeve buxhetore të përcaktuara konform udhëzimeve për hartimin e Programit Buxhetor Vendor. Pjesë e këtij programi buxhetor janë të gjithë projektet kapitale e për më tepër, të gjithë produktet e synuara për tu realizuar brenda periudhës buxhetore afatmesme në konformitet të plotë me politikat, qëllimet dhe objektivat e programeve buxhetore. Tashmë buxheti ynë është formatuar brenda këtyre programeve buxhetore të cilat mbulojnë të gjithë aktivitetin ekonomik – financiar të Bashkisë dhe njësisë shpenzuese në varësi të saj. Me Urdhër të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e Grupit për Strategji, Buxhet dhe Integrim në Bashkinë Fushë - Arrëz” janë miratuar edhe programet buxhetore për periudhën afatmesme 2021-2023.

Mbështetur në planifikimin e të ardhurave dhe kërkesat për shpenzime buxhetore të drejtuesve të programeve si dhe në shpenzimet e nevojshme për financimin e produkteve të Programeve respektive dhe Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Fushë - Arrëz, janë përcaktuar Tavanet buxhetore për sejcilin program në periudhën 2021-2023.


Një tablo me e çartë për trendin e shpenzimeve jepet dhe në materialin e FPT në tabelat F6 dhe F7 si dhe në tabelat e mëposhtme.

Shpenzimet buxhetore 2018 – 2023

Shpenzimet buxhetore sipas programeve buxhetore 2018 – 2023


Kodi	Programi buxhetor	Fakt 2018	Fakt 2019	I Pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	63,571	41,884	70,404	64,994	68,350	65,971
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	42,901	72,310	34,817	34,817	34,817	35,205
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	30,427	64,287	5,304	5,304	5,304	5,360
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	0	1,774	2,130	2,535	2,535	2,535

03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	16,448	12,613	16,207	16,138	16,232	16,518
04240	Menaxhimi i infrastruktuës së ujitjes dhe kullimit	12,814	15,910	2,709	2,709	2,709	2,743
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	9,231	11,168	10,750	10,750	10,750	10,884
04520	Rrjeti rrugor rural	120,868	22,028	13,388	13,388	13,388	13,556
05100	Menaxhimi i mbetjeve	0	5,732	7,356	7,816	7,816	7,816
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	98,879	92,484	96,454	99,145	99,171	99,196
06260	Shërbime publike vendore	30,299	26,047	12,332	13,158	15,205	23,433
06440	Ndriçim rrugësh	0	742	850	1,142	1,142	1,142
10661	Strehimi social	240	0	0	0	0	0
06330	Furnizimi me ujë	32,753	19,220	0	0	0	0
01170	Gjendja civile	2,126	2,581	2,181	2,130	2,130	2,130
06210	Programet e zhvillimit	49,872	0	0	0	0	0
04910	Fondi reserve				1,000	1,000	1,000
04940	Fondi kontigjences				1,000	1,000	1,000
	Totali	510,429	388,780	274,882	274,026	279,549	286,489



Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimi ekonomik 2018 – 2023

Shpenzim et	Fakt 2018	Fakt 2019	I Pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Shpenzimet korrente	308,561	232,816	274,882	277,502	276,214	
Investimi	201,868	155,964	0	2,047	10,275	
Totali	510,429	388,780	274,882	274,026	279,549	286,489



Shpenzimet buxhetore sipas programeve buxhetore 2020 – 2023 kundrejt totalit

Kodi	Programi buxhetor	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	24%	24%	23%
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	13%	12%	12%
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	2%	2%	2%
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	1%	1%	1%
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	6%	6%	6%
04240	Menaxhimi i infrastruktuës së ujitjes dhe kullimit	1%	1%	1%
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	4%	4%	4%
04520	Rrjeti rrugor rural	5%	5%	5%
05100	Menaxhimi i mbetjeve	3%	3%	3%
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	36%	35%	35%
06260	Shërbime publike vendore	5%	5%	8%
06440	Ndriçim rrugësh	0%	0%	0%
10661	Strehimi social	0%	0%	0%
06330	Furnizimi me ujë	0%	0%	0%
01170	Gjendja civile	1%	1%	1%
06210	Programet e zhvillimit	0%	0%	0%

Detyrime të prapambetura paraqiten si me poshte:

Vendime gjykatë me perfitues	Data e detyrimit	Shuma
V.Deda	16.6.2014	2,546,120
Alb prtrol	19.1.2015	1,156,787
Ded Pjetri	28.3.2014	729,200
PAK	29.4.2018	2,433,423
Klement Perndoka	11.7.2018	584,202

Telekom Albania sha	14.12.2018	222,658
Klajdi Lleshi	26.4.2016	1,706,320
Luk Gjini	11.10.2017	671,552
Mark Toplana	26.8.2018	933,128
Junik Shpk	28.9.2018	2,280,502
Ouen shpk	17.12.2019	239,400
Vllaznia ndertim is	12.12.2019	2,301,835
TOTALI:		15,805,827

Keto detyrime jane planifikuar qe te likuidohen ne brenda viteve 2020-2021.

Informacion në lidhje me transfertat

1. Transferta e pakushtezuar e pergjithshme per periudhen 2021-2023, paraqitet sipas tabelës se mëposhtme:

Vitet	2021	2022	2023
Transferta e pakushtezuar	74,190	79,713	85,709

2. Transferta e pakushtezuar sektorial per periudhen 2021-2023, paraqitet sipas tabelës se mëposhtme

Vitet	2021	2022	2023
Transferta e pakushtezuar sektoriale	75,503	75,503	76,447

3. Informacion për programet Buxhetore


Programi Buxhetor:01110-Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi

Pershkrimi i programit:

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzime buxhetore për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme për personelin, shërbime të përgjithme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjete, zyrave të printimit dhe IT etj., shpenzime për ofrimin e shërbimeve që mbështesin veprimtarinë e kryetarit, këshillit dhe komisioneve të këshillit, bazat e të dhënave ven


Shpenzimet e Programit buxhetor

Kodi	Fakt 2018	Fakt 2019	I Pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
01110	63,571	41,884	70,404	64,994	68,350	65,971




Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik

	Shpenzime korrente	Investime
Fakt 2018	59,424	4,147
Fakt 2019	41,013	871
Fakt 2020	70,404	0



	Shpenzime korrente	Investime	
Fakt 2021	47,204	17,790	0
Fakt 2022	49,044	19,306	0
Fakt 2023	49,090	16,881	0



Qëllimi i programit

Qeverisje vendore e përgjegjëse dhe administrata e saj transparente

Objektivi

Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore

Treguesit e rezultatit	Njësia Matëse	Synimet				
		2019	2020	2021	2022	2023
Rritja e kapacitetit të punonjësve të bashkisë	Raporti në % mes punonjësve të trajnuar dhe punonjësve total	11.82	12.21	13.45	14.35	14.35
Rritja e qëndrueshmërisë së administratës civile	Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	12.27	7.04	4.48	2.24	2.24
Rritja e kapaciteteve të punonjësve të bashkisë	Raporti mesatar i ditëve të trajnimit ndaj personave të trajnuar (ditë trajnimi/person)	1.35	0.92	0.73	0.84	0.84
Përmirësimi i punës së stafit të bashkisë	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në numër kundrejt vitit të kaluar)	-1	1	0		

Qëllimi i programit

Qeverisje vendore e përgjegjëse dhe administrata e saj transparente

Objektivi

Përmirësimi i punës së bashkisë drejt realizimit të standardeve ligjore

Treguesit e rezultatit	Njësia Matëse	Synimet				
		2019	2020	2021	2022	2023
Shtimi i aktiviteteve kulturore të organizuara nga bashkia	Numri i shfaqjeve kulturore; artistike të mbështetura me fondet e bashkisë (ndryshimi vjetor në %)	0				

TË DHËNAT E PROGRAMIT

Fakt 2019	Planifikimi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
DITË TRAJNIMI NË TOTAL				
35	24	22	27	27
PUNONJËS TË BASHKISË NË TOTAL				
220	213	223	223	223
PUNONJËS TË TRAJNUAR				
26	26	30	32	32
MASA DISIPLINORE TË MARRA NGA STAFI I BASHKISË				
1	2	2		
PUNONJËS QË JANË LARGUAR NGA ADMINISTRATA BRENDË VITIT				
27	15	10	5	5
NUMRI I SHFAQJEVE KULTURORE; EVENTE ARTISTIKE TË MBËSHTETURA ME FONDET E BASHKISË				
1				


Programi Buxhetor:09120-Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Pershkrimi i programit:

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për pagat për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës, furnizimin dhe mbështetjen me ushqim në kopshte si dhe ndërtimin dhe mirëmbajtjen e strukturave shkollore. Bashkia mbështet programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore;


Shpenzimet e Programit buxhetor

Kodi	Fakt 2018	Fakt 2019	I Pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
09120	42,901	72,310	34,817	34,817	34,817	35,205




Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik

	Shpenzime korrente	Investime
Fakt 2018	34,742	8,159
Fakt 2019	32,543	39,767
Fakt 2020	34,817	0



	Shpenzime korrente	Investime	
Fakt 2021	31,065	3,752	0
Fakt 2022	31,065	3,752	0
Fakt 2023	31,453	3,752	0



Qëllimi i programit

1. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar. 2. Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Objektivi

Bashkia ofron kushte për përmirësimin e arsimit bazë (9-vjeçar) dhe parashkollor

Treguesit e rezultatit	Njësia Matëse	Synimet				
		2019	2020	2021	2022	2023
Mësimi në klasat e arsimit parashkollor zhvillohet sipas standardit kombëtar	<i>Numri mesatar i fëmijëve për një punonjës mësimor në arsimin parashkollor</i>	6.1	6.19	6.1	6.1	6.1
Mësimi në klasat e arsimit parashkollor zhvillohet sipas standardit kombëtar	<i>Numri mesatar i fëmijëve në një klasë të parashkollorit</i>	12.8	13	12.8	12.8	12.8
Mësimi në klasat e arsimit bazë zhvillohet sipas standardit kombëtar	<i>Numri mesatar i nxënësve të arsimit bazë në një klasë</i>	2.5	2.55	2.5	2.5	2.5
Rritja e frekuentimit në sistemin e arsimit bazë	<i>Nxënës të regjistruar në sistemin e arsimit bazë, ndryshimi vjetor në %</i>	-2	2.04	-2	0	0

TË DHËNAT E PROGRAMIT

Fakt 2019	Planifikimi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
-----------	------------------	-----------	-----------	-----------

NUMRI I FËMIJËVE TË REGJISTRUAR NË SISTEMIN PARASHKOLLOR

TË DHËNAT E PROGRAMIT

Fakt 2019	Planifikimi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
128	130	128	128	128
<i>KLASA NË SISTEMIN PARASHKOLLOR</i>				
10	10	10	10	10
<i>NXËNËS TË REGJISTRUAR NË ARSIMIN 9-VJEÇAR</i>				
539	550	539	539	539
<i>KLASA NË SISTEMIN E ARSIMIT BAZË</i>				
216	216	216	216	216
<i>MËSUES NË SISTEMIN PARASHKOLLOR</i>				
21	21	21	21	21


Programi Buxhetor:09230-Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Pershkrimi i programit:

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e institucioneve shkollore, shpenzimet për paga për stafin mbështetës, mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve si dhe administrimin, inspektimin, organizimin ose mbështetjen për transport, ushqim, strehim dhe kujdes shëndetësor të fëmijëve në shkolla


Shpenzimet e Programit buxhetor

Kodi	Fakt 2018	Fakt 2019	I Pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
09230	30,427	64,287	5,304	5,304	5,304	5,360




Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik

	Shpenzime korrente	Investime
Fakt 2018	6,027	24,400
Fakt 2019	5,657	58,630
Fakt 2020	5,304	0



	Shpenzime korrente	Investime	
Fakt 2021	4,484	820	0
Fakt 2022	4,484	820	0
Fakt 2023	4,540	820	0



Qëllimi i programit

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar në arsimin e mesëm të përgjithshëm

Objektivi

Bashkia ofron kushte për përmirësimin e arsimit të përgjithshëm (mesëm)

Treguesit e rezultatit	Njësia Matëse	Synimet				
		2019	2020	2021	2022	2023
Mësimi në klasat e arsimit të mesëm zhvillohet sipas standardit kombëtar	<i>Numri mesatar i nxënësve në klasë</i>	21.67	16.88	21.67	21.67	21.67

TË DHËNAT E PROGRAMIT

Fakt 2019	Planifikimi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
<i>NXËNËS TË REGJISTRUAR NË SISTEMIN E ARSIMIT TË MESËM</i>				
130	135	130	130	130
<i>KLASA NË SISTEMIN E ARSIMIT TË MESËM</i>				
6	8	6	6	6


Programi Buxhetor:03140-Shërbimet e Policisë Vendore

Pershkrimi i programit:

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzime buxhetore të nevojshme për sigurimin e mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe ekzekutimin dhe zbatimin e akteve të tjera të nxjera nga Kryetar i Njësisë dhe vendimet e Këshillit të Njësisë.


Shpenzimet e Programit buxhetor

Kodi	Fakt 2018	Fakt 2019	I Pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
03140 0		1,774	2,130	2,535	2,535	2,535




Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik

	Shpenzime korrente	Investime
Fakt 2018	0	0
Fakt 2019	1,774	0
Fakt 2020	2,130	0



	Shpenzime korrente	Investime	
Fakt 2021	2,405	130	0
Fakt 2022	2,405	130	0
Fakt 2023	2,405	130	0



Qëllimi i programit

Përmirësimi i sigurisë së komunitetit

Objektivi

Rritja e shërbimeve bashkiake për sigurinë dhe qetësinë publike në komunitet

Treguesit e rezultatit	Njësia Matëse	Synimet				
		2019	2020	2021	2022	2023
Rritja e numrit të ankesave të qytetarëve që janë menaxhuar nga policia bashkiake	Raporti në % i ankesave dhe konflikteve të zgjidhura kundrejt numrit të tyre në total të ardhur në policinë bashkiake	109.52	223.33	140	140	140
Punonjësit e policisë bashkiake gëzojnë statusin sipas ligjit	Raporti midis punonjësve me status të oficerit të policisë bashkiake kundrejt numrit total të punonjësve të policisë bashkiake	33.33	33.33	66.67	100	100
Rritja e numrit të ankesave të qytetarëve që janë menaxhuar nga policia bashkiake	Numri i ankesave/konflikteve të zgjidhura nga policia bashkiake, ndryshimi vjetor në %	-31.34	45.65	-16.42	0	0
Rritja e mbështetjes së policisë bashkiake nga policia e shtetit	Numri i rasteve të mbështetura nga policia e shtetit, ndryshimi vjetor në numër	0	0	1	0	0

TË DHËNAT E PROGRAMIT

Fakt 2019	Planifikimi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
NUMRI I RASTEVE TË RUAJTJES SË QETËSISË PUBLIKE				
2	2	2	2	2
MBËSHETJE E POLICISË SË SHETIT PËR NDËRTIMET PA LEJE				
1	1	2	2	2
NUMRI I RASTEVE TË MENAXHUARA NGA POLICIA BASHKIAKE (ZHURMA/KONFLIKTE)				
65	70	50	50	50
ANKESA / KONFLIKTE TË ZGJIDHURA NGA POLICIA BASHKIAKE				
46	67	56	56	56
ANKESA TË ARDHURA NË POLICINË BASHKIAKE				
42	30	40	40	40
PUNONJËS ME STATUSIN OFICER TË POLICISË BASHKIAKE				
1	1	2	3	3
NUMRI TOTAL I PUNONJËSVE TË POLICISË BASHKIAKE				
3	3	3	3	3


Programi Buxhetor:03280-Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Pershkrimi i programit:

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzime buxhetore për të siguruar funksionimin e njësive zjarrfikëse dhe shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmytura etj, si dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe ndërgjegjësimin në komunitet përmes programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.


Shpenzimet e Programit buxhetor

Kodi	Fakt 2018	Fakt 2019	I Pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
03280	16,448	12,613	16,207	16,138	16,232	16,518




